Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

THIRRJE PËR APLIKIM

Thirrje për aplikim të fermerëve për përkrahjen e prodhueseve të Qumështit

Ftojmë fermerët e Komunës së Prishtinës të aplikojnë për subvencione, pagesa direkte, për prodhim të qumështit.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

1. Të jenë banorë të komunës së Prishtinës dhe aktivitetin e tyre prodhues ta realizojnë në territorin e komunës së Prishtinës;
2. Të ofrojnë dëshmi të lëshuar nga laboratori i AUV-së për cilësinë e qumështit, të dorëzuar në qumështore të licencuara ose në ndonjërën nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjërën nga qumështoret e licencuara;
3. Të kenë kontratë për shitjen dhe blerjen e qumështit në mes qumështores dhe fermerit;
4. Të ofrojnë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur;
5. Të kenë dorëzuar së paku 1,000 (një mijë) litra qumësht dhe më së shumti deri në 20,000 (njëzet mijë) litra qumësht për 6 (gjashtë) muaj;
6. Subvencionimi do të bëhet për litër qumësht të dorëzuar, brenda kornizave prej më së paku 1,000 (një mijë) deri në 20,000 (njëzet mijë) litra qumësht;

Dokumentacioni i kërkuar:

1. Kopja e një dokumenti identifikues të Republikës së Kosovës;
2. Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare;
3. Kopja e listës së verifikimit të kafshëve (gjedhet, dhentë dhe dhitë), të lëshuar nga Sektori për identifikim dhe regjistrim në kuadër të AUV-së;
4. Vërtetimi nga Veterinari (kopje);
5. Kopja e kontratës për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështorja apo pika grumbulluese e qumështit e cila blenë produktin (qumështin) nga fermeri;
6. Dëshmia për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose në pikën grumbulluese të qumështit;
7. Dëshmia nga banka për sasinë e qumështit të shitur, për 6 mujorin e parë të vitit 2026;
8. Dëshmia për pjesëmarrjen në projektin "Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit;
9. Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK (vetëm për personat juridik) si dhe dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK.

Aplikimi bëhet nga 12/10/2026 deri 16/10/2026, në objektin e bashkësisë lokale në Besi.

VËREJTJE:

Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, qytetari (fermeri) është i obliguar që t'i sjellë ato në afatin i cili i caktohet, në të kundërtën humbë të drejtën për të qenë përfituesi i grantit.

*Aplikimet pas afatit nuk do të merren parasysh.